



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738

E-mail: rmuca@klsb.org.al; Web-site: www.klsb.org.al

AUDITIMI I PERFORMANCËS "INFRASTRUKTURA E SHËRBIMIT BIBLIOTEKAR KOMBËTAR"

Në zbatim të planit vjetor 2014, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI, etj.), sipas programit të auditimit nr. 100/4, datë 12.05.2014, realizoi auditimin e performancës me temë "Infrastruktura e Shërbimit Bibliotekar Kombëtar". Ky auditim u programua për t'u ushtruar në Ministrinë e Kulturës; Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes; Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë; Bibliotekat publike "Thimi Mitko" Korçë, "Marin Barleti" Shkodër, "Qemal Baholli" Elbasan, "Shefqet Musaraj" Vlorë, "Agim Spahiu" Kukës dhe ato të qyteteve Durrës, Fier e Krujë. Pas përfundimit të punës paraprake audituese më datë 10.05.2014 u përgatit programi auditues. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresën nr. 100/20, datë 24.09.2014 iu dërgua projekt-raporti i auditimit të gjitha institucioneve të mësipërme, përveç Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Raporti i auditimit është hartuar pasi janë shqyrtuar dhe u morën parasysh disa prej vërejtjeve sipas shpjegimeve të dërguara nga institucionet e përfshira në këtë auditim, të cilat janë trajtuar në mënyrë të hollësishme në aneksin përkatës bashkangjitur Raportit të Auditimit.

Në përfundim, pasi Kryetari u njoh me Raportin e Auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga institucionet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Cilësisë, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 9 dhe 16 të Ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997, "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", me ndryshimet e bëra me Ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000:

KONKLUDOI:

Biblioteka ndikon në krijimin dhe mbajtjen e një shoqërie të mirë-informuar, ndihmon njerëzit në pasurimin e zhvillimin e jetës së tyre dhe komunitetit ku ata jetojnë. Përdorimi dhe përdoruesit e bibliotekës janë thelbësorë në zbulimin dhe konfirmimin e vlerës së jashtëzakonshme që ajo ofron. Libri është ngushëlluesi dhe nxitësi i njeriut për ecje drejt shtigjeve të reja. Biblioteka siguron hyrje në dije, informacion dhe vepra, ndërmjet një sërë burimesh e shërbimesh; ajo ofron shërbim të barabartë për të gjithë anëtarët e komunitetit, pavarësisht nga raca, kombësia, mosha, besimi fetar, gjuha, paaftësia, gjendja ekonomike, punësimi dhe edukimi.

Biblioteka jep kontribut të ndjeshëm në gjallërimin e vendit në të cilin është ngritur, si një qendër e rëndësishme e të mësuarit, zhvillimit kulturor dhe artistik të komunitetit, formimit të identitetit kulturor, social dhe shërben si një vend takimi për çdo individ që bëhet pjesë e saj.

Ndërtesat bibliotekare luajnë një rol të rëndësishëm në veprimtarinë e ofrimit të këtij shërbimi. Ato funksionojë në mënyrë të tillë që të reflektojnë funksionet e shërbimit bibliotekar, të sigurojnë një menaxhim efektiv për të realizuar përdorim sa më të mirë të mjediseve e mjeteve bibliotekare për të gjithë komunitetin.

Qëllimi i politikës së Bibliotekës Kombëtare dhe bibliotekave të tjera publike si mbledhëse e deponituesë të informacionit është: **Të grumbullojë, ruajë, përpunojë dhe vërë në dispozicion të përdoruesve e në shërbim të formimit të tyre, gjithë koleksionet e veta.** Përveç kësaj, qëllimi i politikës së bibliotekës përmban në vetvete një sërë objektivash që kanë të bëjnë me cilësinë e shërbimit, kushtet e punës së punonjësve, modernizimin dhe infrastrukturën teknologjike, etj.

Mesazhi kryesor i këtij auditimi është: ***“Biblioteka Kombëtare dhe shërbimi bibliotekar, në bashkëpunim me qeverinë shqiptare, Ministrinë e Kulturës dhe pushtetin vendor, të krijojnë një qasje të re në vlerësim të librit dhe shërbimit qytetar, me synim ruajtjen e kulturës kombëtare dhe rritjen e vetë-edukimit të shoqërisë”.***

Duke vlerësuar hapësirat funksionale në shërbimin bibliotekar dhe kryesisht të Bibliotekës Kombëtare si institucion i dijes dhe kujtesës mbarëkombëtare, në kultivimin e dashurisë për librin, kurimit të imazhit të librit, mbledhjes, ruajtjes, përpunimit, ngritjes së nivelit shkencor e akademik të traditës bibliotekare, është padyshim me vend shtimi i këtyre hapësirave në drejtim të përmirësimit cilësor të shërbimit bibliotekar kombëtar.

Aktualisht, shërbimi bibliotekar dhe veçanërisht Biblioteka Kombëtare e ushtron aktivitetin e saj në kushte të vështira, jo të denja për një institucion të tillë, simbol të kulturës kombëtare. Konkretisht mungojnë hapësirat fizike funksionale, gjë e cila ka përkeqësuar gradualisht ruajtjen dhe zhvillimin e fondit të librit, cilësinë e shërbimit ndaj lexuesit, kushtet e punës për punonjësit, krijimin e një perspektive afatgjatë dhe të qëndrueshme zhvillimi, bashkëpunimet me institucione homologe apo akademike brenda e jashtë vendit, etj.

Disa nga mangësitë e konstatuara gjatë këtij auditimi në mënyrë të përmbledhur janë;

- ✘ nuk është hartuar asnjë strategji afatmesme apo afatgjatë mbarë-kombëtare për bibliotekat publike dhe Bibliotekën Kombëtare.
- ✘ standardet ndërkombëtare në bazë të cilave punon shërbimi bibliotekar dhe BKSJ dihen dhe kanë mbetur brenda këtij shërbimi, çka ka sjellë që organet eprore të mos nxiten “ligjërisht” për reflektim ndaj tyre, lenë në gjendjen që është sot ky shërbim dhe të përballet i **“vetëm”**.
- ✘ shërbimi i bibliotekave dhe në veçanti ai i BKSJ, me gjithë hapat e ndërmarra, ka mungesa të theksuara; në hapësira për përdoruesin dhe personelin; të kushteve në shërbim të përdoruesit me aftësi të kufizuara; mungesa në numrin e personelit bibliotekar dhe ndihmës; hapësirave të pushimit dhe shërbimit; hapësirave për ekspozita; mungesa e kushteve të përshtatshme mjedisore e klimaterike, si dhe të pajisjeve si: tavolina, karrige, kompjuterë; mungesa e orareve të përshtatshme për lexuesin; mungesa të materialeve bibliotekare; etj., të cilat vazhdojnë të jenë gjithmonë në rënie me rritjen e numrit të lexuesve dhe të përdoruesve si dhe procesi i spastrimit të koleksioneve bibliotekare ecën me ritme të ngadalta.
- ✘ Ka mungesa të theksuara të hapësirave për të vendosur materiale bibliotekare; Sipërfaqja e ambientit ku është vendosur fondi i Bibliotekës Kombëtare plotëson vetëm 15% të nevojave të saj. Pjesa tjetër është vendosur jashtë çdo kriteri dhe standardi minimal. Gjithashtu vendi ku ruhet fondi i vlerave të rralla ka mungesa të theksuar të ambienteve, kushteve të sigurisë dhe mjedisore.
- ✘ Ndërtesat bibliotekare në Shqipëri pothuajse janë lënë jashtë vëmendjes së Ministrisë së Kulturës dhe Bashkive, duke i “harruar” ato në gjendjen e tyre si përpara 70-80 viteve a më shumë, ku duhet të veçohet rasti i Bibliotekës Kombëtare si institucioni më i rëndësishëm në këtë fushë.
- ✘ **Mjediset e Pallatit të Kulturës në vartësi të Ministrisë së Kulturës u janë dhënë më qira subjekteve privatë për (librari, bankë, klube, institucione të huaja, etj.) duke mos krijuar kushte për shtimin e hapësirave të BKSJ dhe TOB brenda tij, duke sjellë për pasojë edhe një denatyrim të funksioneve të gjithë godinës së projektuar për të qenë një institucion kulturor.**

- ✘ Nuk është planifikuar ndërtimi i një biblioteke të re për kryeqytetin, të cilit i ka munguar gjithmonë.

Nisur nga konkluzionet mësipërme dhe rezultatet e punës audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të këtij shërbimi **Kryetari** i KLSH-së:

V E N D O S I:

I. Të miratojë Raportin e Auditimit “Infrastruktura e Shërbimit Bibliotekar Kombëtar”, të ushtruar në Ministrinë e Kulturës; Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes; Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë; Bibliotekat publike “Thimi Mitko” Korçë, “Marin Barleti” Shkodër, “Qemal Baholli” Elbasan, “Shefqet Musaraj” Vlorë, “Agim Spahiu” Kukës dhe ato të qyteteve Durrës, Fier e Krujë.

II. Të miratojë rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

1. Rekomandim:

- ✓ Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të Bibliotekave, Komisionin Kombëtar të UNESCO-s pranë MPJ, bashkitë, grupet e interesit dhe aktorë të tjerë të interesuar të hartojnë Strategjinë Kombëtare të zhvillimit të bibliotekave dhe në mënyrë të veçantë atë të Bibliotekës Kombëtare, si një nga institucionet më të rëndësishme në zhvillimin kulturor, shkencor, edukativ, informues dhe ruajtës të trashëgimisë kulturore dokumentare si pjesë të pasurisë kulturore kombëtare.

Menjëherë

2. Rekomandim:

- ✓ Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare, të formalizojë ligjërisht standardet ndërkombëtare dhe përvojat më të mira ndërkombëtare të përdorura nga shërbimi bibliotekar të harmonizuara me ligjin e bibliotekave dhe udhëzimet përkatëse si detyruese për t'u zbatuar nga të gjitha institucionet në shërbim të tij.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Rekomandim:

- ✓ Shërbimi bibliotekar dhe Biblioteka Kombëtare të marrë hapa konkretë për rregullimin e mjediseve dhe veprimtarisë së saj në shërbim të komunitetit dhe përdoruesve të saj.
- ✓ Ministria e Kulturës dhe Qeveria Shqiptare të mendojnë, përpunojnë e implementojnë një plan konkret e afatgjatë për ri konceptimin e shërbimit bibliotekar në të gjithë vendin, sepse aksesimi në informacionin kombëtar, vetë-edukimi dhe forcimi i lidhjes me librin janë motorë zhvillimi në të gjitha fushat e jetës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4. Rekomandim:

- ✓ Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, të marrë hapa konkretë për saktësimin e ambienteve të Bibliotekës Kombëtare **dhe shtimin e tyre, duke i kthyer të gjitha ambientet e Pallatit të Kulturës, Bibliotekës Kombëtare.**
- ✓ Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me Qeverinë, të marrë hapa konkretë për ndërtimin e një ambienti të ri të konceptuar për Bibliotekë Kombëtare.
- ✓ Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me Bashkinë e qytetit të Tiranës si qendra më e madhe administrative e vendit, të përfshijë në planet e saj strategjike ndërtimin e bibliotekës së qytetit që kryeqytetit i mungon aq shumë.
- ✓ Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me pushtetin vendor, të hartojnë plane për ndërtimin e godinave të reja bibliotekare dhe rikonstruksionin e atyre ekzistuese. Kjo të bëhet në përputhje me implementimin e reformës administrative që po vihet në jetë nga qeveria shqiptare.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5. Rekomandim:

- ✓ Në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës të punohet për krijimin e hapësirave të reja; të merren masa konkrete për ruajtjen e fondit të vlerave të rralla në standardet që ato kërkojnë si trashëgimi kulturore shumë shekullore; të merren masa konkrete në avancimin më shpejt të procesit të spastrimit të materialeve bibliotekare.
- ✓ Ministria e Kulturës, Biblioteka Kombëtare, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, të katalogojnë dhe të hartojnë “Pasaportën”, për secilin prej objekteve të luajtshme të trashëgimisë sonë kulturore, pjesë e “Fondit të Vlerave të Rralla” (harta, dorëshkrime, botime të hershme, etj.) pranë Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.
- ✓ Këshilli Kombëtar i Restaurimit në varësi të MK dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës të marrin të gjitha masat organizative për të konsideruar nevojat për restaurim të këtyre objekteve në përbërje të fondit të vlerave të rralla, të cilat mund të jenë dëmtuar nga mungesa e kushteve të ruajtjes në Bibliotekën Kombëtare.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Grupi i Auditimit

Rinald Muça

Alfred Zylfi

Elfrida Agolli

Blerina Kërçuku

Tiranë, Dhjetor 2014